



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VI

Sesioni pranveror

Komisioni për Integritim Evropian

Mbledhja nr. 20

Prishtinë, më 5. 6. 2018 në ora 12:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Blerta Deliu- Kodra, Zenun Pajaziti, Armend Zemaj, Milaim Zeka, Fitore Pacolli Fatmire Kollçaku dhe Fikrim Damka.

Munguan: Ilir Deda, Adem Hoxha, Donika-Kadaj-Bujupi dhe Glauk Konjufca.

I ftuar: Bajram Hasani, ministër i Tregtisë dhe Industrisë.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Ahtere Loxha, Adelina Demolli, Safet Beqiri dhe Florent Mehmeti.

Pjesëmarrësit tjerë: përfaqësues nga GIZ, KDI dhe mediat.

Mbledhjen e kryesoi Blerta Deliu- Kodra, kryetare e komisionit.

Kryetarja, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për punë, e hapi mbledhjen e komisionit me këtë

Rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 11.5.2018;**
- 3. Raportim i z. Bajram Hasani, ministër i Tregtisë dhe Industrisë, për zbatimin e Programit Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim–Asociimit (PKZMSA);**
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-027 për miniera dhe minerale, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**
- 5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-024 për trajtimin e ndërtimeve pa leje, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**

6. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**
7. **Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së dt.11.5.2018

Procesverbali i mbledhjes së dt.11.5.2018 u miratua pa vërejtje.

3. Raportim i z. Bajram Hasani, ministër i Tregtisë dhe Industrisë, për zbatimin e Programit Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim – Asociimit (PKZMSA)

Kryetarja falënderoi ministrin për përgjigje në ftesë dhe tha se në muajin prill, ne e kemi marrë raportin për vendin, i cili paraqet të arriturat dhe sfidat në institucionet e vendit. Duke u bazuar në këtë raport, shihet se nuk është bërë progres i duhur në fushën e industrisë dhe tregtisë. Ne jemi të interesuar të dimë se çka ka bërë ministria juaj për të adresuar sfidat e identifikuara dhe për objektivat e ministrisë që ju e drejtoni, jo vetëm me MSA-në, por edhe për reformat në agjendat evropiane dhe për përafrimin e legjislacionit me BE-në.

Ministri, tha se shumica e progresit që është publikuar në raportin për vendin, i takon Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, por për shkak të fushës që mbulon, ku 60% apo 70% të obligimeve që dalin nga MSA-ja dhe reforma e agjendës evropiane i takojnë MTI-së dhe ka shumë punë për t'u bërë, në këtë drejtim. Ne kemi bërë shumë në përafrimin e disa ligjeve me legjislacionin e BE-së dhe i kemi kaluar në Kuvend. Disa janë në përgatitje të koncept-dokumenteve dhe disa janë në përfundim.

Sa i përket adresimit të sfidave të MTI-së, tha se pikat që janë kërkuar, është struktura sektoriale e ndërmarrjeve, integrimi ekonomik në BE dhe konkurrenca e çmimeve, standardet evropiane, lëvizja e lirë e mallrave, e drejta e kompanive, e drejta e pronësisë intelektuale, mbrojtja e konsumatorit dhe e shëndetit, tregtia, ndërmarrjet dhe politikat industriale. Pra, këto janë fushat kryesore, sa përket përmbushjes së reformave të agjendës evropiane dhe adresimit të sfidave nga raporti i vendit. Kurse, sa përket MSA-së, shumica e obligimeve që janë i takojnë MTI-së.

Ne i kemi marrë me prioritet dhe i kemi klasifikuar të gjitha obligimet dhe kemi ndërmarrë veprimet e nevojshme. Sa i përket akteve nënligjore, së shpejti pritet të formohet grupi punues për hartimin e Rregullores për notifikimin e rregulloreve teknike dhe aktivitetëve për vlerësim të konformitetit të përcaktuar, sipas marrëveshjes ndërkombëtare, pastaj rregullorja për regjistrimin e rregullave teknike dhe trupave të emëruar për vlerësim të konformitetit, është themeluar grupi punues, i cili do ta hartojë udhëzimin administrativ për mënyrën e emërimit të trupave për vlerësim të konformitetit.

Miratohet mandati i Këshillit Shtetëror për Pronësinë Industriale.

Projektligji për tregti me naftë dhe karburante të ripërtëritshme, ka kaluar në të gjitha procedurat e parapara ligjore dhe pas shqyrtimit në kabinet, pritet të dërgohet në Qeveri për miratim.

Lidhur me Ligjin për rezervat e obligueshme të naftës, është formuar grupi punues për draftin fillestar të plotësim-ndryshimit dhe do të përfundohen punët në afatet kohore dhe do t'i procedohet Qeverisë për miratim. Ky ligj ka implikime financiare dhe pas miratimit të këtij ligji duhen rreth 180 milionë € rezerva shtetërore të naftës në Kosovë dhe ne këtu duhet të analizojmë sesi ta bëjmë këtë buxhet, a do ta vendosim një taksë, sa i përket importit të naftës apo buxheti shtetëror, t'i akumulojë çdo vit.

Pas dekretimit të Ligjit për tregti me naftë dhe karburante të ripërtërishme, pritet të themelohet grupi punues për hartimin udhëzimit administrativ për biokarburante. Ligji për konsumatorë është miratuar dhe pas hyrjen në fuqi do të bëjmë përpjekje t'i nxjerrim aktet nënligjore në afat sa më të shpejtë. Te përmirësimi i kornizës së politikave në fushën e inspektimeve, është miratuar koncept- dokumenti në Qeveri dhe është themeluar grupi punues për hartimin e Ligjit për inspektime.

Sa i përket ngritjes së kapaciteteve njerëzore në Drejtorinë e Akreditimit, është bërë përzgjedhja e drejtorit të përgjithshëm të akreditimit.

Gjatë periudhës janar-maj janë adaptuar 170 Standarde evropiane, si standarde kosovare në fushat e mjedisit, derivateve të naftës dhe metrologjisë. Baza e të dhënave të produkteve të rrezikshme, plotësisht funksionale, parashihet të funksionalizohet deri në fund të vitit 2018. Analiza e zbrazëtrave të legjislacionit horizontal për shërbime ka përfunduar në muajin mars. Plani i veprimit për transpozimin e direktivës për shërbime ka përfunduar dhe është dërguar në Qeveri për miratim.

Lidhur me përmirësimin e sistemit ekonomik, gjatë periudhës janar- mars 2018, janë regjistruar 46 biznese përmes platformës elektronike. Kemi bërë unifikimin e numrit të biznesit dhe shumë shpejt presim për të implementuar softuerin e ri, i cili deri më tani ka qenë mungesë e koordinimit ndërmjet MTI-së, doganës dhe administratës tatimore. Për Ligjin për konkurrencë është formuar grupi punues dhe së shpejti do të fillojmë hartimin e koncept-dokumentin. Sa i përket Agjencisë për Promovimin e Ndërmarrjeve të Mesme dhe të Vogla, kemi presion nga Komisioni Evropian që ta bëjmë ristrukturimin e kësaj agjencie dhe ka implikime financiare. Ne e kemi hartuar rregulloren dhe e kemi dërguar në MAP për miratim dhe do të përcillet për miratim në Qeveri.

Zenun Pajaziti, tha se padyshim, MTI është ministri e rëndësishme në fushën e ekonomisë. Në raportin për vendin janë shënuar përparime, por ka ngecje që nuk varen krejt prej jush, sepse janë një varg agjencish që janë në këtë dikaster, që nuk janë plotësisht funksionale.

Te rezervat e naftës, ka disa vite që përsëritët e njëjta në raport. Po ashtu, ka pasur mjaft ide edhe nga ministrat e mëparshëm, dhe njëra prej ideve ishte që në bashkëpunim me Shqipërinë, që në një prej porteve të saj, duhet pasur këto kapacitete për nevojat e ekonomisë s; Kosovës, sepse në rastet e ndryshme ekonomia mund të ketë kolaps. Andaj, pyetja është se a keni ju ide se çka duhet bërë, kur mund të përfundojë kjo dhe a ka mundësi bashkëpunimi me Shqipërinë? Pra, besoj që kjo do të lejohet dhe ministria besoj se i ka bërë kontaktet edhe me Komisionin Evropian dhe Shqipërinë, në mënyrë që kjo mos të përsëritet.

Armend Zemaj, tha se ajo që dëgjuam nga ju ministër , shihet një dinamikë e punës, por tash përfshirja e rregullave të procedurave, konformitetit dhe konkurrencës, është diçka që e vë në pikëpyetje dhe duhet një lëvizje edhe nga institucionet tjera qeveritare. E theksuat që e keni dërguar në MAP rregulloren për ristrukturim të KIESA-s dhe ministrisë, komplet, atëherë na tregoni se a keni vu një afat kohor? Sepse, nga raporti i 3 mujorit që na ka ardhur për përmbushjen e zbatimit të MSA-së, përqindja është shumë e vogël, si Kosovë jemi diku në total, duke përfshirë edhe me juve, nuk ka arritur mbi 29%. Prej të gjitha masave të vitit të kaluar, vetëm një masë ka arritur të zbatohet plotësisht. Në vitin 2017 dhe për 4 mujorin e vitit 2018, është pothuajse e njëjta dinamikë, pa e anashkaluar rolin e Kuvendit në hartimin e legjislacionit

dhe kjo është shqetësim.

Lidhur me Inspektoratin e Tregut, tha se jo vetëm roli fuqizues i Inspektoratit të Tregut, por do të duhej edhe një politikë që do të ishte e përshtatshme me kërkesat e brendshme, sidomos nga ajo çka jemi ballafaquar në kohën e fundit, qoftë me cilësinë e naftës, qoftë me ushqimin, për mishin e dimë të gjithë dhe loja me ndërrimin e çmimeve nëpër marketet e mëdha. Cili është roli juaj dhe sa ju e keni në fokus, duke nënkuptuar edhe konkurrencën, të cilën e përmendi edhe parafolësi, krejt në interes është zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, sepse është një mundësi e mirë që Kosovën ta çojë përpara, pavarësisht dëshirës dhe insistimit tonë që të krijoni një mjedis të mirë për investitorët e jashtëm, të fuqishëm për t'i ndihmuar vendit.

Në vazhdim, tha se nga ajo që kemi dëgjuar gjatë paraqitjes, pjesa e vullnetit është dëshirorë, por për ne është shpresuese dhe për mua personalisht, nëse vazhdoni me këtë dinamikë dhe nëse mund të arrini të ndikoni edhe te linjat tjera qeveritare, atëherë do të keni rezultate, përndryshe, kështu i vetëm edhe në këtë pjesë, është goxha vështirë që brenda këtij viti të kemi një pasqyrë reale të përmbushjes së këtyre aktiviteteve.

Ministri, lidhur me pyetjen e deputetit Pajaziti, sa i përket rezervave të naftës, tha se edhe për shkak të implikimeve financiare duhet kryer këtë obligim, por ende nuk e kemi dhënë ndonjë ide sesi do të jetë forma e deponive, dhe pikërisht për shkak të këtyre implikimeve, e kemi lenë kriterin e fundit për ta plotësuar .

Kurse, lidhur me pyetjen e deputetit Zemaj, tha se ne si ministri e kemi bërë një propozim për ristrukturimin komplet të ministrisë, por agjenci kryesore është KIESA dhe ne si ministri e kemi kryer punën tonë dhe po presim kthimin nga MAP dhe vazhdimin për në Qeveri. Pra, po i presim institucionet tjera.

Kurse, sa i përket inspektoratit, ne si ministri kemi qenë dhe jemi bartës të reformimit që do të bëhet në inspektorat. Kemi kaluar koncept-dokumentin në Qeveri, kemi formuar grupin punues dhe presim shumë shpejt që të fillojë punën dhe ta bëjmë projektligjin, sepse është një reformim i thellë në MTI, por në nivel të vendit, gjithsej janë 42 inspektorate, në nivelin lokal dhe qendror dhe mendohet të reduktohet në 15 ose 16. Kjo ka bërë që ne ta formojmë një grup punues ndërministror, sepse preken shumë ministri dhe ky reformim do të jetë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, i cili do të ketë një inspektor shtetëror dhe ky është edhe rekomandim i Bankës Botërore.

Një koordinim më i mirë mes inspektoratit të nivelit lokal dhe atij shtetëror, rezultati do të jetë shumë më i mirë.

Milaim Zeka, tha se ju ministër keni shkuar në një ministri shumë të rëndësishme, por edhe shumë problematike. Dihet se lëvizja e lirë e mallrave është pikësynim i të gjitha vendeve të Ballkanit, për të hyrë në BE. Pra, do të do të thotë se shtetet që nuk krijojnë një strategji për heqjen e doganave, shndërrohen në shtete diktatoriale, që jetojnë prej doganave. Pra, duke e pasur këtë pikësynim, duhet të ketë një strategji afatgjate, jo vetëm ju, por çdo ministër që vjen në këtë ministri. Në vazhdim, tha se i kishte disa rekomandime, me të cilat duhet të merret ministria.

Lidhur me derivatet e naftës në Kosovë, dihet se cilësia është shumë e keqe dhe kjo shkakton në prishjen dhe amortizimin e makinave. Informacionin që e kam, asnjëherë nuk iu ka bërë kontroll pompave të benzinës. Ju ishte dashur ta formoni Agjencinë për Mbrojtjen e Konsumatorit, sepse cilësia e naftës nuk mund të kontrollohet në një cisternë që hyn në doganë, por cilësia naftës kontrollohet vetëm direkt në pompë dhe ligjërisht, sipas legjislacionit të BE-së, ato pompa duhet të pastrohen çdo vit. Në Kosovë nuk pastrohen dhe ne furnizohemi çdo ditë nga to.

Rekomandimi tjetër ka të bëjë me agjencitë. Në Kosovë ka shumë agjenci dhe këto duhet të zvogëlohen, sepse ato para që shpenzohen në këto agjenci, mund t'i shfrytëzojmë në çerdhe, arsim dhe shëndetësi.

Në vazhdim, tha se ministrat e kaluar kanë dhënë disa vendime që kanë qenë e që janë cilësuar në opinion, si politike, andaj pyes, çka ka ndodhur me vendimin e ish-ministres Bajrami, që kontrolli i cilësisë së naftës t'iu jepet doganave. Kjo është e pamundur, sepse doganat nuk kanë laborator.

Pyetja tjetër është se a keni pasur presion politik, kur keni dhënë vendime për mbrojtjen e konsumatorit vendor, por i keni bërë dëme Serbisë me bllokimin e mallrave?

Fatmire Kollçaku, tha se e dimë që ngecjet në Kosovë nuk janë mungesë e legjislacionit dhe akteve nënligjore, por është edhe moszbatimi i tyre dhe kjo është sfidë kryesore, që së paku legjislacioni ekzistues të zbatohet. Do të ndalesha te mbrojtja e konsumatorit, sepse duke e ditur bilancin import- eksport, tregu ynë është i vërsuar me produkte të ndryshme dhe një koordinim mes ministrisë dhe doganës duhet të jetë shumë më i mirë. E dimë aferën me mishin, sa po përcillen më tutje këto kompani, të cilat licencohen për tregti? Pastaj, e kemi pasur rastin me gazin në QKUK dhe ende nuk kemi nga prokuroria përgjigje, se çka ndodhi me ata persona që vdiqën dhe ende askush nuk ka dhënë përgjegjësi.

Janë procedurat e licencimit të bizneseve, edhe pse ne jemi në favor që t'u jepen lehtësira bizneseve të vogla dhe të mesme, por duhet pasur parasysh në kriteret e licencimit, ku atakohet jeta e konsumatorit. Si Kuvend, ne kemi nxjerrë shumë rezoluta, por që nuk janë obliguese për Qeverinë. Pra, edhe me rastin e mishit, kemi nxjerrë rezolutë, por ne ende nuk e dimë se a është ndërprerë zinxhiri i qarkullimit të atij mishi në tregun e Kosovës dhe sa po vazhdon kontrolli i produkteve që hyn në Kosovë.

Ne duhet ta favorizojmë prodhuesin vendor me lehtësira, për t'i zvogëluar rastet sociale.

Fitore Pacolli, lidhur me cilësinë e derivateve, tha nuk shumë është i rëndësishëm dëmtimi i veturave, por është e rëndësishme është çka del prej veturave, pra ajrin që e thithim çdo ditë.

Kisha dashur të dija se cili është mësimi që e ka marrë ministria, nxjerr nga dënimi që ka marrë kompania "HIB Petrol", nga përdorimi i naftës që nuk lejohet të përdoret në Kosovë, nëpër shkolla është gjetur naftë me 800 PPM, që lejohet vetëm në industrinë e anijeve dhe limiti lejohet 10 PPM.

A mundë na tregoni se cilat janë kontrollet që ju do të siguroheni, që nuk do të ndodhë e njëjta apo nuk do të përdoret nafta e njëjtë edhe në komuna tjera të Kosovës? Dyshohet se nafta, e cila përmban sasi të lartë të sulfurit, përdoret në vetura, të cilat kur të digjen, shkaktojnë dëme në shëndetin e njerëzve.

Ministri, tha se për mbrojtjen e konsumatorit ne kemi bërë shumë, kemi arritur ta aktivizojmë Këshillin Kombëtar për konsumatorë, kemi ndërlidhur një vakum, që ka qenë mes hartimit të politikave, Këshillit për Kombëtar për konsumatorë dhe zbatimit nga drejtoria përkatëse, kemi vendosur një zyrtar që është një urë komunikimi. I kemi bërë disa fushata dhe një promovim, me qëllim të vetëdijesimit të qytetarëve. Sa i përket cilësisë së naftës, është e vërtetë se nuk ka derivate cilësore në Kosovë, por sa i përket importit, nuk është ajo që shkruhet, por problemet janë, sepse ka pika të karburanteve që nga paslufta nuk janë pastruar dhe kjo shkakton probleme, edhe pse derivatet mund të jenë të mira. Këtu duhet të nxirret një udhëzim administrativ, sepse e kemi idenë sesi duhet të vepohet. Ndoshta, duhet t'i jepet

besimi një firme përkatëse, me autorizimin, për ta kryer këtë detyrë. Ne duhet t'i obligojmë pikat e karburanteve, që së paku, një herë në vit, t'i pastrojnë.

Lidhur me mbrojtjen e konsumatorit, tha se ne kemi nxjerrë ligje, të cilat e mbrojnë prodhuesin dhe duke respektuar MSA-në dhe marrëveshjen e CEFT-as, ne kemi arritur dhe iu kemi bërë apel të gjitha kompanive, që aty ku e ndien si kërcënim, që nëse një produkt hyn më lirë sesa prodhohet në vend, ne jemi te gatshëm ta zbatojmë ligjin në fuqi dhe 12 vendime janë në procedurë të hetimeve, duke i verifikuar nga shteti.

Sa i përket zbatimit të ligjeve, tha unë kam gjetur disa ligje të nxjerra, që nuk janë përcjellë me nxjerrjen e akteve nënligjore, por pas marrjes së detyrës sime, për Ligjin për investimet strategjike janë kryer 3 udhëzime administrative, është kaluar rregullorja dhe tani ligji është funksional, si dhe ligjet tjera, jemi duke punuar për t'i kompletuar me akte nënligjore.

Sa i përket mbrojtjes së konsumatorit, në vitin 2017, MTI dhe Departamenti për Konsumatorë, në bashkëpunim me inspektoratin, kanë ndërmarrë një aksion, ku janë asgjësuar shumë mallra në treg, pa afat.

Sa i përket mishit, inspektorati nuk ka mundur të reagojë, sepse është kompetencë e AVUK-ut. Kam kërkuar me shkrim nga AVUK, që ato kompani ushqimore që përdorin më tepër se 20% vaj të palmës, t'u ndalohet përdorimi i tij, sepse është i dëmshëm për shëndetin. Po ashtu, kemi informacione se disa qumështore në Kosovë përdorin 100% vajin e palmës në produktet e tyre, që është shumë e dëmshme për shëndetin. Nuk kemi dashur t'i bëjmë publike ato kompani, por besojmë se me hartimin e Ligjit për tregti të brendshme, i cili është në përfundim e sipër.

Lidhur me importin e naftës nuk është përgjegjëse MTI. Ne mund të koordinohemi me doganën, por nuk jemi direkt përgjegjës dhe jemi në aktivizim të laboratorit të brendshëm, në të cilin do të bëhen analiza, kur kemi dyshime, pra në laborator të akredituar nga MTI, që i bëjnë analizat e derivateve.

Kryetarja theksoi se për t'i mbrojtur konsumatorët, duhet të publikohen emrat e të gjitha kompanive, që bëjnë shkelje të të drejtave të konsumatorëve, sepse përgjegjësia duhet të jetë për të gjithë. Pra, edhe te çështja e vajit të palmës dhe mishit, natyrisht që duhet të keni një koordinim më të mirë, mes jush dhe AVUK-ut, si dhe duhet të merrni masa dhe presion, natyrisht do ta keni mbështetjen e plotë të anëtarëve të komisionit tonë. Ne, po ashtu, do ta mbështesim edhe Ligjin për tregti të brendshme, sepse është në kuadër të standardeve të përafritimit me legjislacionin e BE-së. Pastaj është shqetësues ndërrimi i afateve të skadimit të produkteve ushqimore nëpër markete të ndryshme.

Ministri, lidhur me publikimin e kompanive që bëjnë shkelje, tha se për shkak të sekretit të biznesit, ne nuk duhet ta dëmtojmë dikë në publik, por ne jemi duke punuar shumë dhe inspektorati ka vazhduar punën e vet, me dënimin me gjoba dhe ka dërguar lëndë në gjykata dhe nuk do të ketë falje për asnjërin. Po ashtu, edhe për ndërrimin e afateve të skadimit nëpër markete, MTI do të veprojë konform ligjit dhe e kemi dinamizuar, fillimisht me një plan veprimi me 20% rritje të inspektoratit në kontrolle. Ne kemi kërkuar vazhdimisht rritje

të inspektorëve nëpër fusha të ndryshme.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-027 për miniera dhe minerale, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Pas votimit, kryetarja konstatoi se komisioni nxori këtë:

Rekomandim

Projektligji nr. 06/L-027 për miniera dhe minerale, me amendamentet e Komisionit funksional, nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së dhe mund të rekomandohet për miratim në Kuvend.

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-024 për trajtimin e ndërtimeve pa leje, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Pas votimit, kryetarja konstatoi se komisioni nxori këtë:

Rekomandim

Projektligji nr. 06/L-024 për trajtimin e ndërtimeve pa leje, me amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional, nuk është në kundërshtim me parimet bazë të Acquis të BE-së, prandaj mund të rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt në Kuvend.

6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Pas votimit, kryetarja konstatoi se komisioni, me shumicë votash, nxori këtë:

Rekomandim

Projektligjit nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me amendamentet e Komisionit funksional, nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së dhe mund të rekomandohet për miratim në Kuvend.

7. Të ndryshme

Fatmire Kollçaku, kërkoi informatë nga kryetarja, lidhur me delegacionin e Kuvendit për lobim për liberalizim të vizave dhe tha se i vjen keq, sepse si anëtarë të Komisionit për Integritet Evropian nuk jemi të njoftuar.

Milaim Zeka u ndërlidh në diskutim dhe Po ashtu kërkoi që përmes kryetares, që Kryetari i Kuvendit të ketë kujdes në përzgjedhjen e njerëzve, të cilët do të llojnë për liberalizimin e vizave dhe të formojë një komision me njerëz që kanë integritet dhe kanë kontakte, në Bruksel dhe në Strasburg, me eurodeputetë dhe të llojnë, e jo të merren njerëzit që shkojnë për shëtitje, sepse nuk është koha e qejfeve dhe do të ishte mirë që komisioni ynë mos të injorohet.

Kryetarja theksoi se, sa jam në dijeni, muajin e kaluar, Kryesia e Kuvendit me dakordimin e

shefave të grupeve parlamentare, ka marrë një iniciativë të tillë, që ta ketë një agjendë dinamike, sa i përket liberalizimit të vizave. Pra, kam pasur rast të bisedojë me Kryetarin, që pas dy vizitave, edhe komisioni ynë të ketë diçka konkrete, në këtë drejtim, andaj edhe ju bisedoni me shefat e juaj të grupeve parlamentare, sepse sa jam e informuar, ka pasur një unanimitet, sa i përket përbërjes së delegacionit.

Mbledhja përfundoi në orën 13:20.

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e komisionit.

Kryetare e komisionit,

Blerta Deliu- Kodra
